



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **“TRIANGLE” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, të cilën e përfaqëson Arian Bytyçi**

Janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS: **MEREMETIMI DHE LYERJA E SHKOLLËS FILLORE “HAMËZ THAQI” NË XËRXË**

Numri i Prokurimit: **623-19-5777-5-3-6**

Numri i Brendshëm: **623-19-051-5-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Meremetimi dhe lyerja e Shkollës Fillore “Hamëz Thaqi” në Xërxë**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë prej **2 Muaj**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **[5] ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **Në Shkollë Fillore “Hamëz Thaqi” në Xërxë**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,923.40 Euro**;

(Tremijë e nentëqindnjëzetëetë Euro e katërdhjetë Cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10 % e vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 2 muaj + 30 ditë.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore


13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues:	
Emri:	Arian Bytyçi	Emri:	Astrit Mullabazi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	U.d. Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09 .09.2019	Data:	09 .09.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Paramasa dhe paralogaria per lyerje e Shkolles " Hamëz Thaqi " Xërxe

Lyerja e mureve te mbredshme

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
I	Punë e Demolimit				
1	Demolimi i suvas ne pjese te cilat jane te demtuara ne klasa dhe muret e koridoreve dhe kthinave tjera	m2	450	0.1	45.00
2	Demolimi i fasades ne tavanin e pllatos te hyrja e shkolles si dhe shtyllave dhe mureve te atikes.	m2	36	0.6	21.60
Gjithej:					66.60
II	Punë e Ngjyrosjes dhe gledimit				
1	Furnizimi , transportimi dhe ngjyrosja e mureve me ngjyr te kualitetit te lartes, ne dy shtresa ngjyrë. (Pikmendin e ngjyres e zgjedh investitori ose menagjeri I shkolles).	m2	1420	0.6	852.00
2	Furnizimi , transportimi dhe ngjyrosja e Plafoneve me ngjyr te kualitetit te lartes, ne dy shtresa ngjyrë. (Pikmendin e ngjyres e zgjedh investitori ose menagjeri I shkolles).	m2	1250	0.85	1,062.50
3	Furnizimi , transportimi dhe ngjyrosja e mureve me ngjyr yndyrorë me lartesi te murit H= 1.8m' te kualitetit te lartes, ne dy shtresa ngjyrë. (Pikmendin e ngjyres e zgjedh investitori ose menagjeri i shkolles).	m2	1200	0.95	1,140.00
4	Furnizimi , transportimi dhe ngjyrosja e gredave dhe shtyllave ku jane te llogaritura ne m', ngjyra duhet te jete e kualitetit te lartes, ne dy shtresa ngjyrë. (Pikmendin e ngjyres e zgjedh investitori ose menagjeri i shkolles).	m'	51	1.8	91.80
5	Pergatitja dhe gledimi I mureve, shtyllave dhe gredave me gled ne dy shtresa para ngjyrosjes ne vendet e suvas se demtuar, ne qmim duhet te parashive edhe nje dore baze ne keto vende te gleduara.	m2	450	0.5	225.00
Gjithej:					3,371.30
III	Punë e Fasades				
1	Furnizimi , transportimi dhe vendosja e fasades 1.5mm ne pllafonin e pllatos tek hyrja e shkolles me te gjitha punet tjera percejllse per kete pozicion. Lloin e nuancaeve e zgjeth investitori ose menagjeri i shkolles.	m2	42	5	210.00
2	Furnizimi , transportimi dhe vendosja e fasades 1.5mm ne muret e atikes se pllatos tek hyrja e shkolles me te gjitha punet tjera percejllse per kete pozicion. Lloin e nuancaeve e zgjeth investitori ose menagjeri i shkolles.	m2	32	5	160.00
1	Furnizimi , transportimi dhe vendosja e fasades 1.5mm ne shtyllat e pllatos tek hyrja e shkolles me te gjitha punet tjera percejllse per kete pozicion. Shtyllat deri ne lartesisin H-1m' duhet te punohen nga guri i kolirit. Lloin e nuancaeve e zgjeth investitori ose menagjeri i shkolles.	m'	21	5.5	115.50
Gjithej:					485.50
Rekapitulimi					
1	Punë e Demolimit				66.60
2	Punë e Ngjyrosjes dhe gledimit				3,371.30
3	Punë e Fasades				485.50
Totali:					3,923.40

